



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 4464 prot.

Tiranë, më 25/11 / 2021

Lënda: Kthim përgjigje

QENDRA "RES PUBLICA" ✓

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap.7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur shkresa me nr. 1840/1 prot., datë 09.11.2021 nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me nr. 44464 prot., datë 09.11.2021, deleguar për trajtim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, e cila nëpërmjet Drejtorisë së Emergjencave Civile ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. 44464/1, datë 25.11.2021 si vijon:

"Në përgjigje të kërkesës së ardhur nga ana juaj me nr. 44464 prot., datë 09.11.2021 lidhur me demolimin e pallateve ju informojmë si më poshtë:

Në kuadër të marrjes së masave për rimëkëmbjen, si pasojë e fatkeqësisë natyrore të tërmetit të datës 26.11.2019, Bashkia Tiranë duke patur në fokus të saj mbrojtjen dhe garantimin e shëndetit dhe jetës së qytetarëve, ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në respektim të detyrimeve që rrjedhin nga parashikimet e legjislacionit në fuqi që rregullon përballimin e fatkeqësisë natyrore, në mbështetje të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" dhe në vijim të procedurave për verifikimin dhe përcaktimin e shkallës së dëmtimit në objektet e dëmtuara", mbështetur në VKM nr. 26, datë 15.01.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara", ka vijuar punën për kryerjen e aktekspertizës së thelluar.

Referuar aktkonstatimeve ose aktvlerësimeve paraprake të Institutit të Ndërtimit apo nga grupet përkatëse të inspektimit në terren, në rastet kur është kërkuar një rivlerësim më i thelluar, ka vijuar puna për kryerjen e aktekspertizës së thelluar nëpërmjet operatorëve ekonomik të kontraktuar nga Bashkia Tiranë në zbatim të VKM nr. 26, datë 15.01.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara".

Pasi nga operatori ekonomik i kontraktuar është kryer vlerësimi i aftësisë mbajtëse strukturore, duke marrë parasysh statusin aktual të objektit, kohën e ndërtimit dhe

materialët e përdorura, rrezikun që mund të paraqesi për banorët dhe kur rirforçimi strukturor është me kosto të lartë dhe joefikas, gjithashtu sipas tipit të ndërhyrjeve dhe manualeve të çmimeve të punimeve ndërtimore kostot e përafërta dhe ndërhyrjet për riparimin e strukturës kushtojnë më shumë se 70 % e kostos së rindërtimit (neni 35) Akti Normati Nr. 9, si pasojë përforçimi dhe restaurimi nuk do të ishin të justifikuar nga ana ekonomike, duke rekomanduar prishjen/demolimin e strukturës ekzistuese, bazuar edhe në konkluzionet dhe përfundimet e nxjerra në **oponencën teknike të hartuar nga Instituti i Ndërtimit**.

Si rrjedhojë, bazuar në aktekspertizën e thelluar, projektin e hartuar dhe oponencën teknike të Institutit të Ndërtimit është miratuar me Vendim nga Këshilli Bashkiak prishja e detyruar e objekteve (pallat) si rezultat i dëmtimit nga tërmeti datës 26 Nëntor 2019 me vendimin përkatës për secilin, informacion që jua kemi vendosur në dispozicion edhe me më parë sipas kërkesës tuaj shoqëruar me dokumentacionin badhkëlidhur.

Sa më sipër, ju informojmë se janë 56 pallate që janë shpallur me Vendim të Këshillit Bashkiak për demolim dhe për secilin nga banorët (kryefamiljari) e apartamenteve në këto objekte (pallat) është bërë një njoftim zyrtar i cili është përcjellë me shkresë për secilin prej tyre.

Në vijmë, është ndjekur procedura për zbatimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak për këto objekte nga subjekte të kontraktuar nga Bashkia e Tiranës për kryerjen e këtij shërbimi dhe sipas njoftimeve nga mbikqyrësi i punimeve e gjithë procedura është kryer në mënyrë të rregullt duke qenë prezent në mbarëvajtjen e këtij procesi edhe grup i specializuar i punonjësve të OSHEE dhe UKT me qëllim marrjen e masave për mos të patur ndërprerje të energjisë elektrike dhe linjës së ujësjellësit në objektet përreth.

Gjithashtu, gjatë kryerjes së këtij procesi kanë qenë prezent gjatë gjithë kohës autobotet për të bërë të mundur spërkatjen e vazhdueshme me ujë në mënyrë që mos të ketë ngritje të reve të pluhurit. Prishje e objektit është kryer referuar standarteve të KTZ.

Duke kërkuar mirëkuptimin nga ana juaj, ju informojmë se procedura e demolimit për objektet që janë miratuar me vendim është ende në proces dhe po ndiqet hap pas hapi, për shkak të problematikave të hasura gjatë kryerjes së punimeve, për shkak të ngarkesës lidhur me ndjekjen e këtij procesi dhe stafit të reduktuar, është e pamundur t'ju përgjigjemi në kohë të gjitha kërkesave tuaja të vazhdueshme dhe dokumentacionit voluminoz që kërkohet".

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Blerta Goxha



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 8290/prot.
12

1900
141/5
Tiranë, më 15/12/2021

Lënda: Kthim përgjigje

QENDRËS "RES PUBLICA"
Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap.7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur shkresa nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e cila është protokolluar me nr. prot. 48240, datë 06.12.2021 dhe ka kaluar për shqyrtim te Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, e cila nëpërmjet Drejtorisë së Emergjencave Civile ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. 48240/1 prot., datë 15.12.2021 si vijon:

"Në vijim të kërkesës tuaj lidhur me procedurën e pallateve, që janë miratuar për demolim me Vendim të Këshillit Bashkiak, ashtu si ju kemi kemi bërë me dije edhe më parë nëpërmjet shkresave zyrtare, janë 56 pallate që janë shpallur me Vendim të Këshillit Bashkiak për demolim dhe janë të ndara në 3 procedura sipas datave, kur është marrë vendimi (të cilat ju kemi vendosur më parë në dispozicion me lista, numrin përkatës të vendimit dhe datën për çdo pallat) konkretisht si më poshtë:

20 pallatet e para që kanë dalë me vendim,
28 pallate,

dhe 8 pallate (ku ju sqarojmë se për këto 8 pallate sapo ka nisur procedura dhe nuk kemi procesverbale dhe dokumenta ende.

Gjithashtu, sikurse ju vendosëm në dijeni, për secilin nga banorët (kryefamiljari) e apartamenteve në këto objekte (pallat) është bërë një njoftim zyrtar, i cili është përcjellë me shkresë për secilin prej tyre, ku bashkëlidhur po ju vendosim kopje të njoftimit për vetëm për një nga shumë qytetarët, që ju ka shkuar ky njoftim, pronarë të apartamenteve në objektet (pallat) që do demolohe, për asrye të ngarkesës në punë.

Në vijim, është ndjekur procedura për zbatimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak për këto objekte nga subjekte të kontraktuar nga Bashkia e Tiranës për kryerjen e këtij shërbimi dhe

sipas njoftimeve nga mbikqyrësi i punimeve e gjithë procedura është kryer në mënyrë të rregullt duke qënë prezent në mbarëvajtjen e këtij procesi edhe grup i specializuar i punonjësve të OSHEE dhe UKT me qëllim marrjen e masave për mos të patur ndërprerje të energjisë elektrike dhe linjës së ujësjellësit në objektet përreth.

Gjithashtu, gjatë kryerjes së këtij procesi kanë qënë prezent gjatë gjithë kohës autobotet për të bërë të mundur spërkatjen e vazhdueshme me ujë në mënyrë që mos të ketë ngritje të reve të pluhurit. Prishje e objektit është kryer referuar standarteve të KTZ.

Bashkëlidhur po ju vendosim kopje të procesverbalit për procedurën e ndjekur për një nga objektet (pallate).

Duke kërkuar mirëkuptimin nga ana juaj, ju informojmë se procedura e demolimit për objektet që janë miratuar me vendim është ende në proces dhe po ndiqet hap pas hapi, për shkak të problematikave të hasura gjatë kryerjes së punimeve, për shkak të ngarkesës lidhur me ndjekjen e këtij procesi dhe stafit të reduktuar, është e pamundur t'ju përgjigjemi në kohë të gjitha kërkesave tuaja të vazhdueshme dhe dokumentacionit voluminoz që kërkohet".

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Blerta Goxha



PROÇES VERBAL

Objekti: "Demolimi dhe evadimi i mbetjeve ndërtimore, per 9 (nëntë) pallate"

I mbajtur sot me dt. 02/06/2021 mbi punimet per objektin: "Demolimi dhe evadimi i mbetjeve ndërtimore, per 9 (nëntë)" ne prezence te:

- **Mbikqyresi i Punimeve:** Shoqeria "Zenit & CO" sh.p.k perfaqesuar nga administratori i "Zenit & CO " Sh.p.k" Z. Arqile PERI
- **Kontraktori i Punimeve:** JV "V.A.S. Konstruksion" sh.p.k. & "4 -A M" shpk. perfaqesuar nga administratori i "V.A.S. Konstruksion" sh.p.k Z. Nestor Muhamellari

Pas verifikimit ne vend u konstatua se u kryen keto procese pune:

- U nderpre linja e energjise elektrike ne objektin 165, 165/I-2-3.
- U nderpre linja e rrjetit te ujesjellesit ne objektin 165, 165/I-2-3.

Dhe rezultoi se:

- Me mbeshtetje te grupit te specializuar te punonjesve te OSHEE dhe UKT u moren masa ne menyre qe te mos ketë nderprerje te rrjetit te energjise elektrike dhe linjes se ujesjellesit ne objektet perreth, gjate prishjes se objektit te demoluar.

Verejtje nuk ka.

Lejohet vazhdimi i mbylljes se kanalit me shtresat perkatese sipas projektit.

-Nje kopje per Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë.

-Nje kopje per mbikqyresin e punimeve "Zenit & CO" sh.p.k

-Nje kopje per kontraktorin e punimeve JV "V.A.S. Konstruksion" sh.p.k. & "4-AM"sh.p.k.

KONTRAKTORI


JV "V.A.S. Konstruksion" sh.p.k. & "4-AM"sh.p.k

Drejtues Punimesh me prokure

"V.A.S. Konstruksion" sh.p.k

Drejtues Punimesh

Ing. Marenglen LIKA



MBIKQYRESI

"Zenit & CO" sh.p.k

Administrator

Z. Arqile PERI



PROÇES VERBAL

Punime te maskuara ne objektin "Demolimi dhe evadimi i mbetjeve ndërtimore, per 9 (nëntë) pallate"

I mbajtur sot me dt. 04/06/2021 mbi punimet per objektin: "Demolimi dhe evadimi i mbetjeve ndërtimore, per 9 (nëntë)" ne prezence te:

- **Mbikqyrcsi i Punimeve:** Shoqeria "Zenit & CO" sh.p.k perfaqesuar nga administratori i "Zenit & CO " Sh.p.k" Z. Arqile PERI
- **Kontraktori i Punimeve:** JV "V.A.S. Konstruksion" sh.p.k. & "4 -A M" shpk. perfaqesuar nga administratori i "V.A.S. Konstruksion" sh.p.k Z. Nestor Muhametllari

Pas verifikimit ne vend u konstatua se u kryen keto procese pune:

- Filloi prishja e strukture mbajtese te objektit duke filluar nga kati I siperm ne katet me poshte ne Pallatin 165, 165/1-2-3.
- Transporti I inerteve.

Dhe rezultoi se:

- Prishja e objektit eshte kryer referuar standarteve te KTZ.
- Gjate zhvillimit te procesit te demolimit kryhet edhe sperkatja e vazhducshme me uje ne menyre qe mos te kete ngjitje te reve te pluhurit me ane te autoboteve, te cilet jane prezent gjate gjithë procesit.

Verejtje nuk ka.

Lejohet vazhdimi i mbylljes se kanalit me shtresat perkatese sipas projektit.

-Nje kopje per Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë.

-Nje kopje per mbikqyresin e punimeve "Zenit & CO" sh.p.k

-Nje kopje per kontraktorin e punimeve JV "V.A.S. Konstruksion" sh.p.k. & "4-AM"sh.p.k.

KONTRAKTORI

JV "V.A.S. Konstruksion" sh.p.k. & "4-AM"sh.p.k

Drejtues Punimeshi me prokure

"V.A.S. Konstruksion" sh.p.k

Drejtues Punimesh

Ing. Marenglen LIKA

MBIKQYRESI

"Zenit & CO" sh.p.k

Administrator

Z. Arqile PERI

PROÇES VERBAL

Punime te maskuara ne objektin “Demolimi dhe evadimi i mbetjeve ndërtimore, per 9 (nëntë) pallate”

I mbajtur sot me dt. 05/06/2021 mbi punimet per objektin: “Demolimi dhe evadimi i mbetjeve ndërtimore, per 9 (nëntë)” ne prezence te:

- **Mbikqyresi i Punimeve:** Shoqeria “Zenit & CO” sh.p.k perfaqcsuar nga administratori i “Zenit & CO ” Sh.p.k” Z. Arqile PERI
- **Kontraktori i Punimeve:** JV “V.A.S. Konstruksion” sh.p.k. & “4 -A M” shpk. perfaqcsuar nga administratori i “V.A.S. Konstruksion” sh.p.k Z. Nestor Muhametllari

Pas verifikimit ne vend u konstatua se u kryen keto procese pune:

- U vazhdua me prishjen e strukture mbajtese te objektit duke filluar nga kati I siperm ne katet me poshte ne Pallatin 165, 165/1-2-3.
- Transporti I incerteve.

Dhe rezultoi se:

- Prishja e objektit eshte kryer referuar standarteve te KTZ.
- Gjate zhvillimit te procesit te demolimit kryhet edhe sperkatja e vazhdueshme me uje ne menyre qe mos te ketë ngitje te reve te pluhurit me ane te autoboteve, te cilet jane prezent gjate gjithë procesit.

Verejtje nuk ka.

Lejohet vazhdimi i mbylljes se kanalit me shtresat perkatese sipas projektit.

- Nje kopje per Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë.
- Nje kopje per mbikqyresin e punimeve “Zenit & CO” sh.p.k
- Nje kopje per kontraktorin e punimeve JV “V.A.S. Konstruksion” sh.p.k. & “4-AM”sh.p.k.

KONTRAKTORI

JV “V.A.S. Konstruksion” sh.p.k. & “4-AM”sh.p.k

Drejtues Punimeshi me prokure

“V.A.S. Konstruksion” sh.p.k

Drejtues Punimesh

Ing. Marenglen LIKA

MBIKQYRESI

“Zenit & CO” sh.p.k

Administrator

Z. Arqile PERI

PROÇES VERBAL

Punime te maskuara ne objektin “Demolimi dhe evadimi i mbetjeve ndërtimore, per 9 (nëntë) pallate”

I mbajtur sot me dt. 06/06/2021 mbi punimet per objektin: “Demolimi dhe evadimi i mbetjeve ndërtimore, per 9 (nëntë)” ne prezence te:

- Mbiqyresi i Punimeve: Shoqeria “Zenit & CO” sh.p.k perfaqesuar nga administratori i “Zenit & CO ” Sh.p.k” Z. Arqile PERI
- Kontraktori i Punimeve: JV “V.A.S. Konstruksion” sh.p.k. & “4 -A M” shpk. perfaqesuar nga administratori i “V.A.S. Konstruksion” sh.p.k Z. Nestor Muhametllari

Pas verifikimit ne vend u konstatua se u kryen keto procese pune:

- Filloi prishja e soletave betonarme te objektit duke filluar nga kati I siperm ne katet me poshte ne Pallatin 165, 165/1-2-3.
- Transporti I inerteve.

Dhe rezultoi se:

- Prishja e objektit eshte kryer referuar standarteve te KTZ.
- Gjate zhvillimit te procesit te demolimit kryhet edhe sperkatja e vazhdueshme me uje ne menyre qe mos te kete ngitje te reve te pluhurit me ane te autoboteve, te cilet jane prezent gjate gjithe procesit.

Verejtje nuk ka.

Lejohet vazhdimi i mbylljes se kanalit me shtresat perkatese sipas projektit.

-Nje kopje per Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë.

-Nje kopje per mbiqyresin e punimeve “Zenit & CO” sh.p.k

-Nje kopje per kontraktorin e punimeve JV “V.A.S. Konstruksion” sh.p.k. & “4-AM”sh.p.k.

KONTRAKTORI


JV “V.A.S. Konstruksion” sh.p.k. & “4-AM”sh.p.k

Drejtues Punimeshi me prokure

“V.A.S. Konstruksion” sh.p.k

Drejtues Punimesh

Ing. Marenglen LIKA




MBIKQYRESI

“Zenit & CO” sh.p.k

Administrator

Z. Arqile PERI



PROÇES VERBAL

Punime te maskuara ne objektin "Demolimi dhe evadimi i mbetjeve ndërtimore, per 9 (nëntë) pallate"

I mbajtur sot me dt. 07/06/2021 mbi punimet per objektin: "Demolimi dhe evadimi i mbetjeve ndërtimore, per 9 (nëntë)" ne prezence te:

- **Mbikqyrci i Punimeve:** Shoqeria "Zenit & CO" sh.p.k perfaqesuar nga administratori i "Zenit & CO " Sh.p.k" Z. Arqile PERI
- **Kontraktori i Punimeve:** JV "V.A.S. Konstruksion" sh.p.k. & "4 -A M" shpk. perfaqesuar nga administratori i "V.A.S. Konstruksion" sh.p.k Z. Nestor Muhametllari

Pas verifikimit ne vend u konstatua se u kryen keto procese pune:

- U vazhdua me prishjen e soletave betonarme te objektit duke filluar nga kati I siperm ne katet me poshte ne Pallatin 165, 165/1-2-3.
- Transporti I incerteve.

Dhe rezultoi se:

- Prishja e objektit eshte kryer referuar standarteve te KTZ.
- Gjate zhvillimit te procesit te demolimit kryhet edhe sperkatja e vazhdueshme me uje ne menyre qe mos te ketë ngitje te reve te pluhurit me ane te autoboteve, te cilet jane prezent gjate gjithë procesit.


Verejtje nuk ka.

Lejohet vazhdimi i mbylljes se kanalit me shtresat perkatese sipas projektit.

- Nje kopje per Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë.
- Nje kopje per mbikqyresin e punimeve "Zenit & CO" sh.p.k
- Nje kopje per kontraktorin e punimeve JV "V.A.S. Konstruksion" sh.p.k. & "4-AM"sh.p.k.

KONTRAKTORI

JV "V.A.S. Konstruksion" sh.p.k. & "4-AM"sh.p.k
Drejtues Punimeshi me prokure
"V.A.S. Konstruksion" sh.p.k
Drejtues Punimesh
Ing. Marenglen LIKA



MBIKQYRESI

"Zenit & CO" sh.p.k
Administrator
Z. Arqile PERI





BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

VE N D I M

Nr. 119, datë 28.09.2020

“PËR

PRISHJEN E DETYRUAR TË NDËRTESES PRIVATE (PALLATI NR. 165, NR. 165/1, NR. 165/2, NR. 165/3, RRUGA “TANUSH FRASHËRI”), NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 6, SI REZULTAT I DËMTIMIT NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 34, nenit 35, të Aktit Normativ me nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Ligjit nr. 45/2019, “për mbrojtjen civile”, vendimit nr. 887, datë 24.12.2019 “për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, Vendim nr. 80, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, njësi administrative 6, zona kombinat, bashkia tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese” si edhe në vijim të shkresës me nr. 1515/2 prot., datë 10.07.2020, (protokoluar pranë Bashkisë Tiranë me nr. 21349/1 prot., datë 10.07.2020) të Institutit të Ndërtimit drejtuar Bashkisë Tiranë, memos nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile nr. 30966 prot, datë 17.09.2020, me objekt “Mbi njohjen me aktekspertizat e thelluara të kryera nga Operatorët Ekonomikë të kontraktuara nga Bashkia Tiranë, Oponencat Teknike të kryera nga Instituti i Ndërtimit dhe vijimin e procedurave të mëtejshme”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VE N D O S I:

1. Miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesës private, pallati nr.165, nr.165/1, nr. 165/2, nr. 165/3, rruga “Tanush Frashëri”, në Njësine Administrative nr. 6, Tiranë, mbështetur në akt ekspertizën e thelluar dhe konkluzionin e oponencës teknike të Institutit të Ndërtimit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e objekteve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të vendimit nr. 887/2019, të Këshillit të Ministrave.
3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
1. Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Ojetbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Krugëve dhe Ndriçimit Publik, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, mbështesin Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit.
4. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit njofton 24 orë përpara ndërhyrjes për shembjen e objektit sipas këtij vendimi, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Ndërhyrja për shembjen e objekteve bëhet në prani të përfaqësuesit të prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë dhe Policisë së Shtetit.

5. Për ushtrimin e përgjegjësiave dhe detyrave të parashikuara në pikën 3, të këtij vendimi, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit kërkon asistencën dhe bashkëpunimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.
6. Me qëllim njoftimin e banorëve dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë, si dhe afishohet në standat publike pranë njësisë administrative nr. 6.
7. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit dhe Njësisë Administrative nr. 6, për zbatimin e këtij vendimi.

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.


KRYETARI

TONI GOGU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT



Nr. 15157/2 Prot.

Date: 10/7/2020

Lënda: Dërgim përgjigje për Oponencën Teknike të akt ekspertizës së thelluar

BASHKISË TIRANË

Sheshi "Skënderbej" nr.2, Tiranë



Në bazë të kërkesës suaj me Nr.21349, datë.30.06.2020, protokolluar me lëndën me Nr.15157 Prot, datë.01.07.2020, "Kërkesë për kryerjen e Oponencës Teknike të akt ekspertizës së thelluar", Bazuar në Nenin 34, të Aktit Normativ Nr.9, datë.16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të objektit: "PALLATI 165, 165/1, 165/2 DHE 165/3", RRUGA "TANUSH FRASHËRI", TIRANË, konkludojme se:

Akt ekspertiza e hartuar, nga Ing. Konst. Dhimitër PAPA, jep analizë të gjendjes ekzistuese, të dhëna mbi materialet e ndërtimit, të dhënat nga projekti i zbatimit, dëmtimet, etj.

Sipas Akt ekspertizës objekti është një godinë 5 kate mbi tokë ndërtuar rreth viteve 1960 me një sipërfaqe rreth 960 m²/kat. Sipërfaqja totale llogaritet rreth 4859.80 m² në total. Sistemi strukturor i godinës është me muraturë mbajtëse tulle silikate. Materialet e ndërtimit nga provat rezultojnë me beton C16/20, çelik me fyk=25000N/mm², muratura me fm=1.26N/mm². Koeficienti i sigurisë për këtë objekt është marrë 1.35 (Limited Knowledge).

Nga inspektimet dhe analizat e kryera vihet re që tërmeti i datës 26.11.2019 ka lënë pasojë dhe dëme të konsiderueshme në strukturë.

Struktura është projektuar në bazë të kushteve shqiptare KTP dhe nuk i përgjigjet kërkesave të Eurokodeve, prandaj ka nevojë për tu përshtatur sipas tyre. Në akt ekspertizë jepen dhe tipet e ndërhyrjes në strukturë të cilat konsistojnë në riaftësim përshtatje/përmirësim i plotë strukturor i godinës sipas kërkesave sizmike dhe strukturale referuar Eurokodeve.

Pra Akt Ekspertiza ka dalë me konkluzionin që godina duhet të Riaftësohet/Përshtatet dhe përmirësohet sipas kushteve të reja sizmike dhe strukturale konform Eurokodeve.



Në dokumentet e paraqitura për oponencë teknike është dhënë dhe projekti i përf forcimeve i hartuar nga shoqëria "Atelier 4", shoqëruar me raportin teknik përkatës.

Në raportin e vlerësimit strukturor autorët shprehën:

Perfundimisht, mund të konkludojmë, që kjo ndërtesë në gjendjen egzistuese i plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë për ngarkesa statike por nuk i plotëson ato për ngarkesa dinamike sizmike, referuar gjendjes së pare kufitare si dhe kriteret e shërbimit në ulje dhe deformime referuar gjendje së dyte kufitare (gjendjes kufitare të shfrytëzimit) duke u bazuar në Eurocode për aktivitet sizmik me $PGA = 0.260 g$.

Struktura e objektit në gjendjen egzistuese nuk i plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë për një vend sizmik siç është Tirana dhe duhet të nënshtrohet restaurimit dhe përforcimit, mbi bazën e specifikave teknike të projektit përkatës bashkëngjitur. Duke iu referuar kostove ndërtimore në treg, për një ri aftësim strukturor me standarde cilesore dhe destinacionit si objekt banimi do të vlerësojmë një vlerë totale rreth 24 658 022 leke.

Rekomandojmë që struktura e mesipërme të përforcohet dhe të restaurohet konform projektit përkatës.

Rekomandime për ndërhyrjet strukturore të nevojshme për kthim të strukturës konform kushteve teknike dhe përshtatjen sipas standardeve shqiptare ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme

Në bazë të analizave të kryera autorët kanë dalë në përfundimin që struktura të kthehet në standartet e sigurisë të kërkuara nga kodet e softme Europiane të projektimit duhet të nënshtrohet ndërhyrjeve përf forcuese.

Projekti i përforcimit konsiston në përforcimin e elementëve strukturore.

Struktura do të përforcohet duke ndërhyrë në muret mbajtëse me veshje me beton torcrete (me rezistencë jo më pak se 40 MPa) dhe zgara celiku T 131 me diametër 5 mm/150 mm. Zgarat do të lidhen me shufra terthore me diametër 8 mm dhe do të vendosen në të dyja faqet e mureve. Të dyja zgarat do të lidhen me shufra-fitila terthore të vendosura konform projektit konstruktiv.

Soletat, të realizuara me panele të parapregatitura do të përforcohen duke përdorur zgara të tipeve T 188 sipër dhe T 92 poshtë. Nga sipër soletat do të vishen me beton C20/25 dhe nga poshtë do të vishen me beton torcrete. Lidhja e të dyja shtresave do të bëhet me shufra terthore të cilat do të futen në zonat e bashkimit të paneleve. Soletat gjithashtu do të lidhen me muraturen nëpërmjet shufrave të cilat do të inkastrohen në faqen e jashtme të murit me anë të pllakave metalike.

Projekti i përforcimit është i detajuar dhe me shënime të nevojshme teknike. Materialet që do të përdoren janë konform kushteve teknike. Mbi bazën e këtij projekti është hartuar dhe një preventiv me një vlerë të punimeve të përforcimit 132,446,115.0 lekë me tvsh e cila duke e krahasuar me vlerën totale të ndërtimit të objektit nga e para $4859.50 m^2 \cdot 32113 \text{ lekë}/m^2 = 156,062,757.4$ duke iu referuar kostove ndërtimore në treg për një sipërfaqe të njëjtë është më e madhe se 70 %, ($84.6\% > 70\%$).

Pra si përfundim mund të themi se Akti eksertiza e thëlluar për objektin "PALLATI 165, 165/1, 165/2 DHE 165/3", Rruga "Tanush Frashëri", është e detajuar dhe e bazuar në studime, prova laboratorike dhe analiza strukturore të plota.





BASHKIA
TIRANË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE NË BASHKËPRONËSI,
ADMINISTRIMIT TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE
DHE EMERGJENCAVE CIVILE
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 33060/prot.
30

Tiranë, më 28.08.2021

Lënda : Njoftim.

Z/ZNJ. FERDANE LAZE ✓

Adresa: Pallati Nr. 165/1/2/3, rruga "Tanush Frashëri", Njësia Administrative Nr. 6,

Për dijeni :

NJËSISË ADMINISTRATIVE NR. 6

I/E nderuar z/znj. Laze,

TIRANË

Në kuadër të marrjes së masave për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Durrës dhe Tiranë", për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 Bashkia e Tiranës ka ndjekur procedurat për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në objektet e dëmtuara, mbështetur në VKM Nr. 26 datë 15.01.2020 "Për kryerjen e Aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara", Aktin Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

Bazuar në verifikimet dhe akt konstatimet paraprake të Institutit të Ndërtimit, grupeve të punës së njësive administrative për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe rrezikun që paraqitej, është kryer aktekspertiza e thelluar për objektet e dëmtuara.

Për pallatin nr. 165/1/2/3, rruga "Tanush Frashëri", Njësia Administrative Nr. 6 është kryer aktekspertiza e thelluar nga operator ekonomik të kontraktuar nga Bashkia e Tiranës mbështetur edhe nga opoenca teknike e Institutit të Ndërtimit, ku ekspertët kanë dalë në konkluzionin se pallati duhet të demolohet.

Me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 119 datë 28.09.2020 është vendosur demolimi i detyruar i objektit, pallati nr. 165/1/2/3, rruga "Tanush Frashëri", Njësia Administrative Nr. 6.

Bashkëlidhur dokumentacioni.

Ju falenderoj për mirëkuptimin

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Aurël Cuko

[Signature]



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 44464 prot.

Tiranë, më 25/11/2021

Lënda: Kthim përgjigje

QENDRA "RES PUBLICA"

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap.7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur shkresa me nr. 1840/1 prot., datë 09.11.2021 nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me nr. 44464 prot., datë 09.11.2021, deleguar për trajtim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, e cila nëpërmjet Drejtorisë së Emergjencave Civile ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. 44464/1, datë 25.11.2021 si vijon:

"Në përgjigje të kërkesës së ardhur nga ana juaj me nr. 44464 prot., datë 09.11.2021 lidhur me demolimin e pallateve ju informojmë si më poshtë:

Në kuadër të marrjes së masave për rimëkëmbjen, si pasojë e fatkeqësisë natyrore të tërmetit të datës 26.11.2019, Bashkia Tiranë duke patur në fokus të saj mbrojtjen dhe garantimin e shëndetit dhe jetës së qytetarëve, ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në respektim të detyrimeve që rrjedhin nga parashikimet e legjislacionit në fuqi që rregullon përballimin e fatkeqësisë natyrore, në mbështetje të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" dhe në vijim të procedurave për verifikimin dhe përcaktimin e shkallës së dëmtimit në objektet e dëmtuara", mbështetur në VKM nr. 26, datë 15.01.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara", ka vijuar punën për kryerjen e aktekspertizës së thelluar.

Referuar aktkonstatimeve ose aktvlerësimeve paraprake të Institutit të Ndërtimit apo nga grupet përkatëse të inspektimit në terren, në rastet kur është kërkuar një rivlerësim më i thelluar, ka vijuar puna për kryerjen e aktekspertizës së thelluar nëpërmjet operatorëve ekonomik të kontraktuar nga Bashkia Tiranë në zbatim të VKM nr. 26, datë 15.01.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara".

Pasi nga operatori ekonomik i kontraktuar është kryer vlerësimi i aftësisë mbajtëse strukturore, duke marrë parasysh statusin aktual të objektit, kohën e ndërtimit dhe

materialet e përdorura, rrezikun që mund të paraqesi për banorët dhe kur rirforçimi strukturor është me kosto të lartë dhe joefikas, gjithashtu sipas tipit të ndërhyrjeve dhe manualeve të çmimeve të punimeve ndërtimore kostot e përafërta dhe ndërhyrjet për riparimin e strukturës kushtojnë më shumë se 70 % e kostos së rindërtimit (neni 35) Akti Normati Nr. 9, si pasojë përforçimi dhe restaurimi nuk do të ishin të justifikuar nga ana ekonomike, duke rekomanduar prishjen/demolimin e strukturës ekzistuese, bazuar edhe në konkluzionet dhe përfundimet e nxjerra në **oponencën teknike të hartuar nga Instituti i Ndërtimit**.

Si rrjedhojë, bazuar në aktekspertizën e thelluar, projektin e hartuar dhe oponencën teknike të Institutit të Ndërtimit është miratuar me Vendim nga Këshilli Bashkiak prishja e detyruar e objekteve (pallat) si rezultat i dëmtimit nga tërmeti datës 26 Nëntor 2019 me vendimin përkatës për secilin, informacion që jua kemi vendosur në dispozicion edhe me më parë sipas kërkesës tuaj shoqëruar me dokumentacionin badhkëlidhur.

Sa më sipër, ju informojmë se janë 56 pallate që janë shpallur me Vendim të Këshillit Bashkiak për demolim dhe për secilin nga banorët (kryefamiljari) e apartamenteve në këto objekte (pallat) është bërë një njoftim zyrtar i cili është përcjellë me shkresë për secilin prej tyre.

Në vijim, është ndjekur procedura për zbatimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak për këto objekte nga subjekte të kontraktuar nga Bashkia e Tiranës për kryerjen e këtij shërbimi dhe sipas njoftimeve nga mbikqyrësi i punimeve e gjithë procedura është kryer në mënyrë të rregullt duke qenë prezent në mbarëvajtjen e këtij procesi edhe grup i specializuar i punonjësve të OSHEE dhe UKT me qëllim marrjen e masave për mos të patur ndërprerje të energjisë elektrike dhe linjës së ujësjellësit në objektet përreth.

Gjithashtu, gjatë kryerjes së këtij procesi kanë qenë prezent gjatë gjithë kohës autobotet për të bërë të mundur spërkatjen e vazhdueshme me ujë në mënyrë që mos të ketë ngritje të reve të pluhurit. Prishje e objektit është kryer referuar standarteve të KTZ.

Duke kërkuar mirëkuptimin nga ana juaj, ju informojmë se procedura e demolimit për objektet që janë miratuar me vendim është ende në proces dhe po ndiqet hap pas hapi, për shkak të problematikave të hasura gjatë kryerjes së punimeve, për shkak të ngarkesës lidhur me ndjekjen e këtij procesi dhe stafit të reduktuar, është e pamundur t'ju përgjigjemi në kohë të gjitha kërkesave tuaja të vazhdueshme dhe dokumentacionit voluminoz që kërkohet".

Sa më sipër lutemi në dëftimin tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT


Blerta Goxha